

Genetic Relationship Sumerian-Albanian, as a contribution to the study of both languages

Albanian language might give to Assyriology & Sumerology a valuable contribution. Through the arguments on the genetic relationship between Albanian and Sumerian languages, it could be of interest the deepening into the Sumerian origin of the unstressed forms of the personal pronouns of Albanian language, especially those of the third person singular, whose origin, formation, and development to the present forms, continue to remain unclear for Albanology.

It would also be valuable, a comparison on the –ak form of genitive/possessive in Sumerian –ak / ake (-a.ki⁴/ke⁴), and its presence in Albanian as a phonetically and semantically equal element to the forms of present Albanian genitive.

For the argumentation of the genetic relationship of Albanian and Sumerian, it is very important the paradigm of the verb "to be", which might be present and functioning as word formation stabilizant with its third person singular “is” = a/ash/asht in Albanian, which equals the “a” in Sumerian, as such, furnishing us another argument against the known reasoning of Pedersen, en+esti.

How are represented the unstressed forms of personal pronouns, the genitive, and the verb "is" of Albanian in Sumerian language?

The existence of the so-called Dimensional Prefixes (DP) in Sumerian, and their characteristics and functions, paralleling in whole, to the unstressed forms of personal pronouns of Albanian (including the merged ones), seems to be a convincing argument on genetic relationship of both languages. Including the equal ergativity function of "e" (3.sg unstressed form of Alb. personal pronoun), they tell us that Albanian might contribute in the study of Sumerian.

Si paraqiten format e patheksuara të përemrave vetorë, gjinorja, dhe folja *është* e shqipes në gjuhën shumere?

ANASTAS S. SHUKE

Studiues/Përkthyes

Adresa: Blvd. P. N. Luarasi, P.44/1, Tirana

ALBANIA

anastas.shuke@gmail.com

Për lidhjet gjenetike të shqipes e shumerishtes, një argument me rëndësi do ishte origjina shumere e formave të patheksuara të përemrit vetor të shqipes, format fillestare dhe zhvillimi i të cilave mbeten ende të paqarta. Gjithashtu do vlente një krahasim për ndërtimin e gjinores së shumerishtes me prapashtesën –ak dhe prania e saj në gjuhën shqipe.

Një rëndësi të madhe merr paradigma e foljes ndihmëse *jam* e cila duket se gjendet dhe funksionon si *stabilizant* fjalformues, apo krijues emrash foljorë, në formën e saj të vetës së tretë njëjës *është* të shqipes që përkon me *a* në shumerisht, argument tjetër ky ndaj arsytimit të njohur të Pedersenit, en+esti.

Tiparet e parashtesave të dimensionit DP në gjuhën shumere përkojnë me ato të formave të patheksuara të përemrit vetor të shqipes. Ky përkim, përfshirë ergativitetin me \underline{e} , duket të jetë argument bindës për lidhjet gjenetike mes dy gjuhëve.

Asnjë gjuhë tjetër nuk është më afër shumerishtes sesa indoevropianishtja, - *M.C.Vidal*

Gjuhët indoevropiane dhe semitike kanë një rrënjë të përbashkët

Gjuha shumere vijon të mbetet e paklasifikuar në asnjë grup gjuhësor. Studimi i saj ka kaluar përmes persishtes e akadishtes. Këmbëngulja për veçimin, edhe nga gjuhët e afërta gjeografikisht, ka nxitur studime krahasuese, edhe si ai i M.C.Vidal, i cili thotë se “asnjë gjuhë tjetër nuk është më afër shumerishtes sesa indoevropianishtja”.

Përcaktimi i atdheut të lashtë të popujve i.e. dhe i kohës së ndarjes së gjuhës bazë, lidhet me ruajtjen/humbjen, me njësimet/ndarjen e tërë tipareve të gjuhës (E.Likaj,18).

Nga tezat e paraqitura për këtë çështje, teza fillestare lindore (TL) e atdheut aziatik të indoevropianëve, dhe ajo me ndryshime lidhur me vendin e origjinës dhe datimin (TLN) këtu në vijim, gjen mbështetje reciproke në lidhjet mes shqipes e shumerishtes.

E. Meyer-i vërente mjaft përkime në strukturën gjuhësore të indoevropianishtes dhe familjes semitohamite, në fjalëformim, eptim dhe sintaksë. Nehringu, shprehej se ato do të kenë qenë në fqinjësi diku në Azi. Pra, indoevropianishtja e semitohamitishtja kanë një rrënjë të përbashkët. (E.Likaj, 26-28).

Në shumerisht: a=ujë, u=ujë

Aos > A+os > U+os > Ui+os > Vi+os > Vjos – Vjosë

Pikpamjet e P.Kretschmer-it një mbështetje për TLN

Hidronimia e lashtë e Evropës, dhe tërë shtresa i.e. e emrave të përveçëm sipas H. Hirt-it është kryesisht e periudhës së ndarjes së gjuhëve. Duke ndjekur parimin e analogjisë, bazuar në zgjatjen 2000 vjeçare të ndarjes së gjuhëve balte, mund të përcaktojmë kohën e ndarjes së gjuhës-bazë (E.Likaj,31). Gjuhët më të vjetra i.e (hitite, sanskrite, greke) janë dokumentuar në rreth 700-1500 pr.k, pra mund ta kenë filluar ndarjen që prej fillimit të mijëvjeçarit III pr.k, gjë që përkon me vijimësinë e shumerishtes prej neolitit deri në fillesat e akadishtes, ndarje që dokumentohet rreth 2400 pr.k, dhe me fundin e kulturës shumere (zhvendosjen përfundimtare, - A.Sh.) në rreth 2000 pr.k.


Pra, shtresa e I-rë indoevropiane e emrave të përveçëm të Evropës, mund të datohet prej gjysmës së dytë të mijëvjeçarit III pr.k. e këtej, në përputhje me prejardhjen sipas TLN. Një argumentim i burimit shumer të hidronimisë i.e. është etimologjia e emrit të lumit Aos > Vjosë.

TLN mbështetet edhe në pikpamjet e P.Kreçmerit i cili e mendonte nënshtresën pellazge si të prejardhur nga Anatolia (*Hititët i.e.*) pra, nga vende në kufi me Shumerin. Kreçmeri e vendoste gjuhën proto-i.e. në ultësirat e Azisë dhe e mendonte ndarjen e saj në rreth 2500 pr.k, që përkon me zëvendësimin e kulturës shumere nga ajo akade dhe me datimin e dyndjeve proto-i.e. drejt Evropës.

Atdheu i lashtë i popujve indoevropianë ka qenë Shumeri Shumerishtja mund të jetë gjuha-bazë indoevropiane

Duke u bazuar edhe në lidhjet gjenetike të shqipes si gjuhë i.e. me shumerishten, lidhje që shtrihen në rrafshin leksikor dhe në strukturën gramatikore, mund të paraqesim Tezën Lindore të Ndryshuar TLN:

“Atdheu i lashtë i popujve indoevropianë deri nga fundi i mijëvjeçarit III pr.k. ka qenë Shumeri. Evropa u bë, pjesërisht, atdheu i ri i tyre, nga mijëvjeçari i dytë e këtëj, që duket se përkon me datimin e mundshëm të hidronimisë së saj të lashtë dhe tërë shtresës i.e. të emrave të përveçëm. Shumerishtja mund të jetë gjuhë i.e, madje të jetë vetë gjuha-bazë i.e.”



Dyndjet Proto-IE 2500-2200 pr.k.
Invazioni Dorian 1300-1200 pr.k.

Pellazgët dhe Ilirët, ura lidhëse historike shumero-shqiptare barbar > babbar = i bardhë barbar < par+par = më i parë = i lashtë

Pelargos < pe+larg < pe+lan+g < prej tokës' lanë; pe (pi/pri) rrënja i.e. e rreshtorit i parë

Pellazgët e ilirët duket të jenë ura lidhëse historike mes shumerëve e shqiptarëve, siç na tregon edhe etimologjia semantiko-aglutivative e etnonimit Pellazg, e bazuar në leximin e ç'mitizuar, literal, të të dhënave për ta. Emërtimi grek për pellazgët është *barbar.oi* - nuk flet greqisht. Shumerishtja: *barbar > babbar* = i bardhë (Hayes,26). Me ligjësitë morfonologjike të shumerishtes *barbar < par+par > më i parë = i lashtë*. Pellazgët gjendeshin këtu para ardhjes së grekëve, sipas Kreçmerit, përpara pushtimit dorian në 1200 pr.k, dhe të dhënat tregojnë se grekët gjetën aty një kulturë plotësisht të zhvilluar, e cila duhet ta ketë arritur kulmin e parë të saj që nga fillimi i mijëvjeçarit të dytë pr.k. (Sh.Demiraj¹,28).

Sipas Pausanias, Pelargos-i është i pari njeri i lindur në tokë, me etni prej një qytetërimi Neolitik (si ai *shumer*); Danaos-i thoshte: “Unë jam pelazg, bir i Geas së Lashtë”, pra: “bir i Ki-së/Dheut të Lashtë” (gea<ki.a, atdheu i lashtë); Pausania, si edhe Asius i Samos-it, na rrëfejnë: “Pelasgu, ai që ngjante me hyjnitë, ka lindur nga toka e zezë”. Toka “e zezë” > “me naftë” duket të jetë Shumeri.

Straboni përdor për Pellazgët termin “Pelargos”, që mund të jetë formuar nga Pe+Larg+os < Prej Larg. Parafjala *pe/prej* (pi/pri) rrënja i.e. e rreshtorit *i parë*; kuptimi duket se bartet nga buzorja *p-*. Ndajfoljen *larg* shqipja duket ta ketë prej fondit të hershëm i.e. pasi mund ta shpjegojmë etimologjikisht më mirë brenda shqipes.

Pelarg+os<pe+larg<pe+lan+g<pe+lan+ki = prej tokës së lanë

Pellazg/Pellazgji<pe+lash+gi = prej gjirit/dheut që lashë / pe+lasht+g

Pelasht <pe+lasht+k < prej Dheut të Lashtë Lë+asht > Lasht ki>gi>gji>dhe'

Burimi i ndajfoljes *larg* mund të jetë aoristi i foljes *lë/lâ*, në v.3, shumës - *lan(ë)*, që duket të ketë rotacizëm: *larg<larëg<lanëg<lan+g*, ku: -g mund të jetë mbetja e *gi/ki = tokë/dhe'/vend*, pas rënies së -i në pozicion fundor të patheksuar. Pra, mund të kemi etimologjinë: *Pelargos<pe+larg<pe+lan+g<pe+lan+ki = prej tokës lanë* (rendi, ki dëftor).

Australian G.Murray, (f.43) e ndan termin Pelasgoi në: *pelas+g+oi =neighboring land - vend fqinj*, duke veçuar *g=vend*. Prapashtesa -g lidhet me shumeren *gi/ki = tokë, vend, dhe'*; po kështu: *pelaz/pelaš < pe+lash*. Pra: *Pellazg/Pellazgji<pe+lash+gi = prej gjirit/dheut që lashë*. Kalimi *gi>gji>dhe'* duket i mbështetur fonetikisht.

Para zanores së çelët -i, grykore-velarja g- është palatalizuar në gj-; pra, në fazën I (para-ilire) kemi: ki > gji. Kalimi gji>dhe' duhet t'i përkasë një faze të mëvonshme, ndoshta pararomake, ku palatalja gj- u dentalizua në dh-.

Termi *Pelasg* gjendet edhe në trajtën *Pelasht* (Demiraj^{1,29}). Mundet: *Pelasht<pe+lasht*. Po ashtu, nëse këtu ka një -t geminate -tt, e meqë gjenden raste kur *k>t* (*ki/ti*) ose *kt > t*, mund të kemi: *pelasht<pe+lasht+t<pe+lasht+k* (*pelaztg/pelashtg*). Kuptimet e “i lashtë” dhe “lashë” (aoristi i *lë*) janë të afërta, madje sipas rregullit fjalformues të shumerishtes (folje+a = emër/përcaktor, ku a=ash/asht/është e shqipes, sh. në vijim) mund të kemi: *Lë+asht > L+asht > Lasht⁶*, dhe përfundojmë: **Pelasht <pe+lasht+k < prej dheut të lashtë, prej Shumerit.**

Mbështetje për vijimësinë shumer-pellazg-ilir-arbër-shqiptar përbën numizmatika dhe heraldika ilire, si edhe Emblema e Skënderbeut

Një mbështetje për vijimësinë shumer-pellazg-ilir-arbër-shqiptar përbën numizmatika ilire si dhe heraldika ilire dhe arbërore. Në numizmatikën ilire gjejmë përdorimin e shenjës shumë të Zotit ✨, të stilizuar në version statik dhe rrotullues, në mjaft emisione monedhash të periudhës pr.k, në mburoja ilire, si dhe në mozaikun e Tiranës, dhe në krye të emblemës së Skënderbeut. Prejardhja shumë e kësaj shenje vërtetohet nga prania e saj në pllaka të panumërta të shkruara me kunjiform në Shumer, ku për këtë shenjë ka të dhëna të bindëse që shpjegohen e lidhen qartë përmes gjuhës shqipe. Gjithashtu, etimologjia e emrit *Iliria - Illyria* – *Ylli.ri.a* duket të jetë *yll i ri*, pasi shenja kunjiforme e Zotit ka edhe leximin *il=yll*.




Figura mbi Ungjill dhe në dokumentin më të vjetër gur gëllqoror me kunjiform të nietur në Kish datuar 3.500nr.k



Fonetika e shumerishtes si gjuhë e vdekur e izoluar, pa të dhëna krahasuese. Rindërtimi i sistemit fonetik të shumerishtes e i shqiptimit të saktë të cilitdo tingulli të saj nuk është i lehtë. (Hayes,22)

Shumica e të dhënave për fonetikën e shumerishtes kanë kaluar përmes filtrit të sistemit fonetik të akademikut 1900-1600 pr.k, e të persishtes së vjetër. Shkrimi kunjiform i shumerishtes mendohet se kishte fonetizim të ulët dhe pra, ndryshimet fonologjike vihen re me vështirësi.

Shumerishtja kishte të paktën zanoret *a, u, o, i, e*. Zanorja *o* nuk ekziston në akadish dhe është e vështirë të dallohet nga *u*, prandaj përgjithësisht nuk përdoret gjatë transliterimeve të kunjiformit shumer. Ka edhe rindërtime me 8 zanore: *a, ä, i, e, ë, o, u, y*.

Shumerishtja kishte të paktën bashkëtingëlloret: *b, p, d, t, g, k, m, n, η/ġ, z, s, sh, ħ, l, r, dr*. Shqiptimi i tyre është afër atij në shqip, *η/ġ* shkruhet në këto dy forma dhe shqiptohet si *n/ng/nj*, por ka raste si *m, g*. Nga Boisson, 1989 sibilanti *z* interpretohet si *ts=c* dhe *sh=th*. Ka mendime për dy tipe likuidesh *l* e *r*, ndoshta *ll* dhe *rr*. Bashkëtingëllore të gjata mund të dalin prej asimilimit si p.sh: *barbar > babbar* = i bardhë.

Sistemi i shkrimit kunjiform, siç mendohet deri tani, jep informacion morfologjik tepër të kufizuar e madje, për shumerologët nuk është ende e qartë si veçohet një fjalë në shumerisht. Kramerer thoshte 50 vjet më parë se, “nuk ka ardhur ende koha për rishikim shkencor të sistemit të transliterimit” (rindërtimit morfologjik, - A.Sh, 2012), dhe ende sot vijon të përdoret i njëjti sistem pavarësisht nga pasaktësitë e shumta që rrjedhin prej tij, ku shqipja me lidhjet e saj gjenetike me shumerishten mund të japë një ndihmesë të pazëvendësueshme.

Problemet e origjinës së paradigmës së foljes ndihmëse *jam* të shqipes dhe paralelizmi i **en esti* të Pedersenit me togun *a.ni* të shumerishtes

Stabilizanti *a*: folje+a/ash = emër foljor dëftori anaforik *ni>i/ni/nji/një,ai*

Sqarimi historik i ndërrimeve morfonologjike të vëna re për foljen *jam*, në raport me gjuhët i.e. kanë qenë objekt i studimeve të shumta si ato të Bopp-it, Meyer-it e shumë të tjerëve. Megjithatë çështja e ndërrimit *a>e* në v.2 ndaj v.1-nj, prania e tingullit *-sh-* në disa forma e mungesa në të tjerat, si dhe nistorja *â-* në v.3 njëjës nuk është sqaruar ende, madje në tërësi, përfshirë prejardhjen e pranuar përgjithësisht të temës *je-* si refleks i **es-*, çështja e zanafillës së paradigmës së foljes *jam* nuk është sqaruar ende siç duhet si nga ana etimologjike edhe e ndërrimeve morfonologjike.

Pedersenit e nxjerr prejardhjen e formës *âshtë* nga togu **en esti* – “brenda është”, ku hundorja *ê* çon në *â-* (geg), *ë-* (tosk). Por ekzistenca e një togu të tillë, zëvendësimi i foljes prej tij, dhe përngjitja hundorizuese që e kërkon theksin mbi ndajfoljen *en*, nuk mund të arsyetohen, dhe përngjitja duhet të ndodhte në një periudhë shumë të hershme, që pas saj të binte *e-* tek *esti* për të mos patur rotacizëm.

Paradigma e foljes *jam*, duket të kalojë nga përdorimi i shpeshtë në “sh” i togut *a.ni*, që ndoshta është pikërisht ç’ka kërkonte Pedersenit me propozimin **en esti*. Këtu *a-*, që lexohet *ash* kur rrokja pasardhëse nis me zanore, quhet stabilizant prapashtesë e foljes që krijon emra e mbiemra foljorë: the *noun that verbs është* (ky), (Halloran,1). Pra, folje+a/ash = emër foljor. Mund të pranohet njësia e “stabilizantit” *a/ash* të shumerishtes dhe foljes *a/ash/asht/ë/ësh/është* të shqipes (mbart.ës,ndarës,gërmues,etj). Përbërësi *-ni* duket i njëjtë me *i/ni/ nji/një* p.pakuf, që e përmban edhe kupt. e dëftor/vetorit *ai*, siç del tek Halloran,117,193,194.

Zanafilla shumere e paradigmës së foljes ndihmëse *jam* të shqipes.

a.ni / ash.ni = është ai/ajo/dikush v.3 a/ash–tema/rrënjë në të trija vetat e njëjësit *ti=jetë* v.2 e *jam: ash.ti > a.ti > e.ti > je.ti > je ti* v.1 *a.mu>am.u>jam.u>jam un*

Nisur nga ngjashmëritë fonetike me eptimin e foljes *jam* në gjuhët shqipe, sanskrite, greke e latine (E.Likaj,17), njësia e stabilizantit *a/ash* të shumerishtes me foljen *a/ash/asht/është* merr rëndësi edhe sepse *a/ash* duket të jetë fillesa e eptimit të foljes *jam* apo rrënja/tema e saj, e përdorur për të trija vetat e njëjësit në shumerisht e shqip¹⁷. Veç kësaj, tingulli homorganik *m* duket merr pjesë në v.1 (njëjës e shumës) të shumerishtes *am₃* si dhe të gjuhëve të mësipërme, e po ashtu tingulli *t* për vetën e dytë e të tretë.

Tingulli *t* në këto gjuhë duket të jetë mbetja e fjalës shumerisht *ti=jetë*. Kjo mundet semantikisht të jetë burimi i tingullit *t* dhe i përemrit vetor *ti*, e bashkë me *a/ash* të përbëjë burimin e v.2 të foljes *jam: ash.ti > a.ti > e.ti > je.ti > je ti*, në ngjashmëri fonetike edhe me eptimin në sanskritisht *asi (as.ti)*. Kalimi *a > e*, metafoini e *a-* që vjen nga *-i* e gjatë e rrokjes pasardhëse *-ti*. Diftongimi *e > je* është bërë për të zhdukur hiatin si te *at - i jati*, ndoshta pas përdorimit *e.ti > ti.e > ti je*.

Në shumerisht togu *am₃*, mendohet si v.3 njëjës e foljes *jam* (Hayes,144). Togu *am₃* përbëhet nga shenjat kunjiforme 𐎠𐎵𐎠𐎡𐎹 . Por shkrimi O.ON mbi ikonën e Zotit përkthehet *unë jam*. Paralelizmi nga ana e formës, e bën të mundur njësimin kuptimor, A.AN=O.ON. Përbërja e *am₃* AN=*me/mi/mu: a+me/mi/mu>am₃>a.mi/a.mu*; tek *a.mu>am.u>jam.u>jam.un* edhe *u>un>unë* (sanskritisht *asmi*). Duket se *j-* edhe këtu është shtuar për të zhdukur hiatin ndoshta pas përdorimit *u.am*, dhe *-n* për të shprehur një *û* hundore.

Zhvillimi historik i v.3 njëjës të foljes *jam* prej shumerishtes

a.ni > a.ni.ti > âsht+a.ni > âsht+âj / është+ai

Zhvillimi i shumësit me përsëritjen e njëjësit: *a.mi+a.mi > jemi*

Lidhur me v.3 njëjës mund të themi se togut *a.ni* më pas iu shtua *-ti* për analogji me v.2 njëjës: *a.ni > a.ni.ti* (kuptuar si *a.ni.jet*), e cila pas asimilimit të *n* në *â* hundore mori përsëri *sh* (nga *a=ash*), dhe njëkohësisht u theksua *â*-ja hundore, u asimilua *i*-ja e mbetur nga *ni*, dhe *i*-ja e gjatë fundore e *ti* që humbi theksin, u reduktua në *-ë* ose u asimilua, pra, *a.ni.ti > â.i.ti > âsh.ti > âsht(ë)/është(ë)*. Humbja e kuptimit të *ni* ndoshta shtoi përsëri një tog anaforik *a.ni*, i cili pas hundorizimit të *â* u reduktua në *âj*, pra, *asht+a.ni > âsht+âj*. Pra, për v.3 njëjës kemi:

a.ni > a.ni.ti > âsht+a.ni > âsht+âj / është+ai, në ngjashmëri fonetike edhe me eptimin në sanskritisht *as.i (as.ni)*.

Lidhur me numrin shumës, duhet patur parasysh se në shumerisht, shprehja e shumësit me përsëritje është forma më e dukshme dhe më e pranuar (Hayes,84,200). Nga *am(i) > am₃* mund të kemi shumësin: *ami+ami > am.iami > am.jami > jami > jem*, që përputhet me mendimin e La Pianës. Metafonia *a>e* ka ndodhur për shkak të *i*-së së gjatë tek *mi* e theksuar. Po kështu mund të jetë formuar v.3 sh. nga *a.ni > a.ni+a.ni > an.ia.ni > an.jan > jan*. V2. sh. është formuar për analogji të v2.nj *je* dhe v3.sh *jan* dhe për të mos patur homofoni. Për origjinën e përemrave vetorë përkatës *ne, ju, ata/ato* kërkohet një punë të mëtejshme.

Arrijmë kështu në tabelën krahasuese të zhvillimit historik të paradigmës së foljes *jam* për kohën e tashme të mënyrës dëftore:

Tabela krahasuese e zhvillimit historik të paradigmës së foljes *jam* për kohën e tashme të mënyrës dëftore

Paradigma e foljes *kam* në analogji me foljen *jam* + dëftorin *ki*

Tabela në vijim pasqyron raportin kohor pra, rradhën e prejardhjes:

Shumerisht	Shqip	Sanskritisht	Greqisht	Latinisht
am ₃ (A.MU/AN)	jam u(n)	asmi	eimi	sum
a.ti	je ti	asi (as.ti)	ei/essi	es
a.ni.ti (a.ni)	asht.aj	asi (as.ni)	esti	est
ami+ami	jami>jem(i)	smah (m+m=mah)	eimes	sumus
a.ti+a.ti?	jen(i)	<u>sthah</u>	esti	estis
a.ni+a.ni	jan>janë	<u>santi</u>	easi/eisi	sunt

Në shumerisht *ki* mund të zëvendësojë një emër të përveçëm (PN), pra, duket të jetë e njëjtë me përemrin dëftor të shqipes *ki=ky*. Dihet se kuptimi bartet nga bashkëtingëlloret dhe, siç duket në këtë rast, nga *k-*. Një argument do ishte arsyetimi se fillimisht ajo që u nda mes njerëzve në imja dhe jotja ishte toka – *ki*. Atëhere mund të arrijmë në **zanafillën e formimit të foljes ndihmëse *kam***, tema zanafillëse e së cilës u krijua mbi bazën e foljes *jam* duke i shtuar asaj objektin e pronësisë, - tokën *ki* ose *k-* (*ki/ke*<>*ki₄/ke₄*).

Gjinorja e shumerishtes me -ak, si ndërfutje sintaksore në sistemin rasor, një argument tjetër për lidhjet gjenetike me shqipen.

Formimi rasës gjinore në shumerisht duket i ndryshëm nga gjuhët i.e, një ndërtim sintaksor më vete i ndërfutur në sistemin rasor (Hayes,66). Gjinorja i.e, si rasë që shpreh marrëdhëniet në një grup emëror, shprehet sot me mbaresat përkatëse dhe me ndihmën e nyjeve pronore, si *i,e,të,së* në shqipen. Por në fazën paragramatikore gjinorja i.e. shprehej me pasvendosje e përngjitje të fjalëve (E.Likaj,34), psh. dëftorit anaforik (*ki*), formë që duket edhe në shumerishten, ku gjinorja realizohet kryesisht me prapashtesën *-ak*, (Hayes,42). Kjo në kunjiform paraqitet si kombinim pjesësh të dy shenjave, $-a.k- < ma.ki_4/ke_4$. ($ke_4 > kjo e/ja/jo$).

Edhe në shqip kemi përdorimin e prapashtesës *-ak* si psh: durrsak, ushtarak, fshatarak, vezake, etj., të cilat semantikisht shprehin rasën gjinore apo njëfarë raporti pronësie: i Durrësit, i ushtrisë, i fshatit, (me formën) e vezës. Duket qartë përkatësia e gjinisë *ak*-mashkullore dhe *ake*-femërore me burim shumerishten.

Shumerishtja duket të na japë çelësin e zbërthimit etimologjiko-semantik të shqipes në morfema më të thjeshta (deri në fonema), i cili për prapashtesën *-ak* është: $a.k(i)=asht.k(y)$, si psh. durrsak = i Durrësit $a(sht) k(y)$; vezake = e vezës $a(sht) k(jo)$. Ky zbërthim tregon se prapashtesa *-ak* përbën, siç thotë Hayes, një ndërtim sintaksor, një fjali. Edhe e_2 – pronore.

Përfundojmë se gjinorja e shumerishtes, si ndërfutje e njëjtë në shqipen dhe etimologjia e saj përmes shqipes është një argument tjetër, sintaksor, për qënien e saj gjuha bazë i.e, dhe për lidhjet gjenetike me shqipen.

Në kohën e krijimit të f.p.p.v në gjuhën shqipe duket të ekzistonte rendi kundrinë-kallzues (OV) ose kundrinë-kallzues-kryefjalë (OVS) në ngjashmëri me tipologjinë e rendit të fjalëve në shumerisht

Për format e patheksuara të përemrave vetorë të shqipes nuk është sqaruar ende kënaqshëm historikisht, zanafilla dhe rrethanat sintaksore të krijimit dhe përdorimit të tyre si përsëritëse të kundrinës së drejtë e të zhdrejtë. Nga ana morfologjike është i paqartë burimi dhe koha e zanafillës veçanërisht për vetën e tretë njëjës e shumës *e, i, u, i*, por mendohet se janë mbeturina të një vetori të vetës së tretë me origjinë dëftori, ndërsa dy vetat e para janë përfutur nga format e plota përkatëse (Demiraj³, 113, 114, 146). Vjetërsia dhe evolucioni fonetik i hershëm i f.p.p.v. dëshmohet nga vendosja pranë foljes dhe nga përbërja fonematike e përgjithësuar në të gjitha të folmet e shqipes, përfshirë trajtat e përngjitura (Demiraj³, 121). (Përgjithësimi i k.zh/k.d_{1,2} –i plotë; k.d₃ –kusht theksi).

Sa i përket rendit, f.p.p.v kallzore vendoset më afër foljes (më e lidhur me të) se ajo e dhanores, pra, në rastin e f.p.p.v të përngjitura ajo e dhanores vendoset para f.p. të kallzores. Pra, nuk mund të përjashtohet se, në kohën e krijimit të formave të patheksuara, kundrina në gjuhën shqipe vendosej më fort para foljes (Sh.Demiraj³, 120). Duke ditur edhe se, në shqipen e hershme, kryefjala zakonisht nuk shprehej, atëherë mund të supozohet se në kohën e krijimit të f.p. në gjuhën shqipe fjalja mund të niste me kundrinën (emër, përemër, + f.p.) dhe vijonte me kallzuesin, ndërsa kryefjala mund të ishte në fund, pra duket të ekzistonte rendi kundrinë-kallzues (OV) ose kundrinë-kallzues-kryefjalë (OVS).

Rasa ergative në –e jep një kuptim më të mirë, më intuitiv të rolit veprues të kryefjalës dhe të rolit të kundrinës (Hayes,9). F.p. e v.3 njëjës e na jep përcaktim dyfish të kundrinës, veç atij nga eptimi.

Në shumerisht rasa ergative shënohet me “mbaresën” –e. Shembullin e Hayes (*the boy rolled the ball down the hill*) mund ta shkurtojmë në shqip deri në: *topin e rrokullisi*. F.p.p.v. e v.3 njëjës e na jep një përcaktim të dyfishtë, veç atij nga eptimi, një kuptim më të mirë, më intuitiv të rolit veprues të djalit, pikërisht siç e ka sqaruar profesor Hayes vetinë e ergativitetit të shumerishtes. Një trajtim të tillë të f.p.p.v e gjejmë edhe tek Sh.Demiraj³,113,134, 138,142 ku ato përcaktohen si *përsëritëse* redundante të kundrinës, si përcaktuese të dyfishta të saj për ta bërë më të qartë kumtin.

Në pikëpamje të rasës ergative, *mbaresa* apo f.p. e i referohet agjentit, vepruesit, por me homonimin e paraqitet edhe *mbaresa* e rasës vendore-fundore që shënon objektin/vendin *mbi/në* të cilin ndodh ngjarja / veprimi, pra kundrinën (D.Foxvog,54). Në këtë rast duket të kemi përsëritjen e kundrinës me anë të *mbaresës*/f.p. e, siç shpjeguar më lart. Përputhja fonematike dhe kuptimore e *mbaresës* e të rasës ergative me f.p. e të shqipes dhe homonimia në shumerisht e rasës ergative dhe rasës vendore-fundore shprehur me *mbaresën* e, tregon se kemi të bëjmë me të njëjtin funksion sintaksor të analizuar nga dy këndvështrime të ndryshme, e raportit me vepruesin dhe raportit me kundrinën. Gjithashtu, *mbaresa*/f.p. e paraqitet edhe si parashtesë *ergative* e togut foljor (D.Foxvog,69), që nënkupton se ajo është një element morfo-sintaksor më vete, njëlloj si në gjuhën shqipe.

Parashtesat DP në togun foljor të shumerishtes, risjellin / lidhin marrëdhëniet e rasave në fjali, në marrëdhënie një për një. DP e dhanores - gjithnjë e para, pas saj vjen DP ergative (D.Foxvog,69)

Paraqitja e saj në kunjiform nga shenja ke_4 , me leximet ki_4 , ge_2 , dhe kid , ku mund të kemi të bëjmë me dëftorin zanafillës $ki/ke > ky/kjo$, që e përmend në mënyrë implicite Demiraj³,146. Prejardhja e f.p. \underline{e} duket të jetë prej leximit ke , burim i dëftorit të sotëm kjo ($-e > -ja > -jo$), mbështetur edhe me arsyetimin se \underline{e} nënkupton termin përgjithësues $gjë$ në vend të kundrinës konkrete, term i cili është i gjinisë femërore. Madje edhe vetë termi $gjë$ duket e ka burimin tek termi shumer $ki(ky)=tokë$, që siç thamë ka dhënë gji afër me $gjë$ ($i > ë$), pra, f.p.p.v. e v.3 njëjës \underline{e} na risjell/përsërit, $gjë < ki/ke/kit/ket > kët/këtë$, formën e vet të theksuar $këtë$. Tek dëftorët ki/ni ndoshta e ka burimin f.p. v.3 njëjës \underline{i} e dhanores, por për këtë duhet një punë e mëtejshme.

Parashtesat e quajtura të dimensionit DP në *togun foljor* të shumerishtes, risjellin/rregjistrojnë/lidhin marrëdhëniet e rasave në fjali, në një marrëdhënie të përcaktuar saktë një për një. DP-të përbëhen nga elementë përemërorë dhe mund të jenë edhe të përngjitura, por DP e rasës dhanore është gjithnjë e para, pas saj mund të vijë DP-ja ergative (D.Foxvog,69), që është f.p.p.v e v.3 njëjës \underline{e} . Parashtesat DP- duken redundante, apo përsëritëse të panevojshme që nuk përcjellin ndonjë kuptim, por, thotë Hayes, ato ndihmojnë qartësinë e kumtit, që informacioni të mos ngatërrohet (Hayes,44).

Duket edhe këtu se gjithë ç'thonë Hayes dhe Foxvog për tiparet e DP-ve të shumerishtes, paralelizon me format e patheksuara të përemrit vetor të shqipes siç i trajton Prof.Demiraj, paralelizëm që duket të jetë argument bindës për lidhjet gjenetike mes dy sjuhëve

FALEMINDERIT

Përfundime

Me tezën TLN, ku gjuha shumere merret si gjuha bazë i.e., e me lidhjet përkatëse gjenetike të saj me shqipen, nënkuptohet një vijimësi e tillë nga gjuha bazë drejt gjuhëve të veçanta i.e, ku shqipja është gjuha që i trashëgon karakteristikat i.e, më drejtpërdrejt, dhe mbi të gjitha, që përdor fjalë me rrënjët/temat më të shkurtra, deri në fonema me kuptim. Pikërisht kjo shkurtësi, që është një karakteristikë e pranuar edhe për shumerishten, duket na flet për një gjuhë sintetike-analitike të arrirë, që ia del të kumtojë diçka, më qartë e pa ekuivoke, më saktë e relativisht më shpejt. Gjuhët motra të gjuhës-bazë si ajo sanskrite, greke, latine duket të jenë në fakt, shmangje nga ecuria e transformimeve gjuhësore të shumerishtes, dhe kjo ka patur ndikim më pas mbi gjuhën shqipe, për arsye se ato kanë qenë gjuhët e shkruara pas zhvendosjes së kulturës shumere ne Evrope prej rreth 2000 pr.k.

Zanafilla shumere e paradigmës së foljeve ndihmëse *jam* dhe *kam*, që u jep përgjigje të mbështetur fonetikiisht problemeve të pasqaruara deri më sot mbi origjinën dhe zhvillimin historik të eptimit të këtyre foljeve, duket të jetë argument bindës për lidhjet gjenetike të shqipes e shumerishtes, dhe të qënies së saj gjuha-bazë indoevropiane.